



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Priljezo / Prodato Received / Delivery		17 - 11 2023 viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHK	7024	2023	1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1186/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1186/2023 të datës 20.09.2023 të parashtruar nga ankuesi , me adresë banimi Rruga "Shefki Kuleta", në Komunën e Podujevës, kundër Konkursit me numër të referencës RN00011927 të datës 21.06.2023, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1186/2023 e datës 20.09.2023 e parashtruar nga ankuesi .
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.13-362/23 i datës 19.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Podujevës.

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës më datë 21.06.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00011927 për grupin *Specialit të Administrimit të Përgjithshëm* për pozitën „Zyrtar për Rexhistrimin e Bizneseve” si dhe ne pozitën „Zyrtar për Gjendjen Civile 4” ku afati për aplikim ka qenë nga data 12.07.2023 deri më datë 26.07.2023.

Në këtë konkurse ka aplikuar edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak ndërsa është ftuar të marr pjesë në testin me shkrim, ku në bazë të rezultatit në testin me shkrim ka

arrit 50 pikë në vlerësimin e jetëshkrimit 4.82 pike ndërsa në vlerësimin e intervistës me gojë ka arrit gjithsejtë 12.6 pikë.

Bazuar në Renditjen përfundimtare të kandidatëve të publikuar më datë 14.09.2023 rezulton se ankuesi nga të gjitha fazat e vlerësimit ka arritur gjithsejtë 67.42 pikë ku rezulton se nuk ka arrit pike të mjaftueshme për të qenë pjesë e listës së kandidateve fitues, ku palëve të pakënaqura me vlerësim i është dhënë mundësi për ankesë në afat prej tri ditësh.

Ankuesi më datë 14.09.2023 ndaj këtij vlerësimi ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimi në Komunën e Podujevës. Komisioni i Pranimi në Komunën e Podujevës më datë 19.09.2023 ka nxjerr Vendimin me numër Nr.13-362/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi rezultatet përfundimtare të vlerësimit.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër Nr.13-362/2023 të datës 19.09.2023 të Komisionit të Pranimi në Komunën e Podujevës, më datë 20.09.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.1186/2023 me numër protokoll 6164/2023, me pretendimet ankimore se testi me shkrim ka përmbajtur pyetje që nuk ndërlidhen me pozitat e shpallura, lista lidhur me rezultatet e testit me shkrim nuk është publikuar, nuk është respektuar parimi i rëndësishëm që është i transparencës, pyetjet e intervistës kanë qenë jo të strukturuar, si dhe nuk kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 26.10.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës. Ndërsa, Këshilli më datë 29.09.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Më datë 01.11.2023 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr vendim përmes të cilit ka shtyrë afatin për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6164/2023 të datës 20.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër NR.13-362/23 të datës 19.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.09.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 29.09.2023; Konkursin e datës 21.06.2023; Vendimin me numër Nr.02-020/04-0055996/23 të datës 03.08.2023; Njoftimin e datës 28.07.2023; Aplikacionin e ankuesit të datës 19.07.2023 së bashku me dosjen e tij; Diplomën universitare me numër.7595 të datës 08.09.2021 me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar Universitetin e Prishtinës Fakultetin Juridik dhe mori titullin Bachelor i diplomuar; Dokumentin e identifikimit; Pasqyra e Llogarisë Trustin për periudhën kohore 15.07.2022 deri me datën 14.07.2023; Certifikatën mbi dënimet penale; Aplikacionin e datës 26.07.2023 të e kandidatës B. , së bashku me dosjen e saj; Diplomën me numër 5804 të datës 27.07.2022 me të cilën dëshmohet se kandidatja ka përfunduar studimet Themelore në Universitetin e Prishtinës Fakultetin e Gazetarisë;

Certifikatën lëshuar në Qershor-2022 lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin e Coca-Caola përkrah Rininë në bashkëpunim me innovation Center Kosovo; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit Social Media Marketing Trening në Maj-2023; Marrëveshjen e datës 04.10.2022 për realizimin e masës aktive të tregut; Certifikatën me numër 518/2019 të datës 25.10.2019; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën mbi dënimet penale; Aplikacionin e datës 20.007.2023 të kandidatës J.Zymeri së bashku me dokumentacionin përcjellës; Diplomën me numër 148/18 të datës 08.02.2018 të me të cilën dëshmohet se ankuesja ka përfunduar studimet themelore në Kolegjin AAB dhe mori titullin bachelor i Administratës Publike; Kontratën e Punës të datës 01.12.2010; Kontratën e punës të datës 01.12.2010; Kontratën e punës të datës 01.12.2010; Kontratën e Punës të datës 01.12.2010; Kontratën punës të datës 01.12.2010; Marrëveshjen për angazhim ne masën aktive të tregut të punës praktike në punë të datës 03.10.2022; Marrëveshjen për angazhimin në masën aktive të tregut të punës të datës 03.04.2023; Letër referencën (pa datë dhe numër) të lëshuar nga Drejtoresha e Administratës në Komunën e Podujevës; Vërtetimin me numër 13-239/2022 të datës 24.08.2022; Letër referencën e datës 30/05/2023; CV e kandidatës; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën mbi dënimet penale; Vlerësimin individual të Biografisë së kandidatëve në vendin e punës të datës 06.09.2023 për kandidatin B. , Vlerësimin individual të Biografisë së kandidatëve në vendin e punës të datës 12.09.2023 për kandidatin B. , Vlerësimin individual të Biografisë së kandidatëve në vendin e punës të datës 12.09.2023 për kandidatin J. , Vlerësimin individual të Biografisë së kandidatëve ne vendin e punës të datës 06.09.2023 për kandidatin , Vlerësimin individual të Biografisë së kandidatëve në vendin e punës të datës 06.09.2023 për kandidatin , Vlerësimin individual të Biografisë së kandidatëve në vendin e punës të datës 12.09.2023 për kandidatin , Rezultatet e vlerësimit të datës 14.09.2023; Rezultatet e vlerësimit të datës 19.09.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstaton se pretendimet e ankuesit janë të *pabazuara, sepse:*

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se testi me shkrim ka përmbajtur pyetje që nuk ndërlidhen me pozitat e shpallura, lista lidhur me rezultatet e testit me shkrim nuk është publikuar, nuk është respektuar parimi i rëndësishëm që është i transparencës, pyetjet e intervistës kane qene jo të strukturuar dhe nuk kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet.

Nga provat e lëndës, respektivisht në bazë të konkursit me Nr. Reference: RN00011927 për grupin *Specialit i Administrimit e Përgjithshëm* për pozitat "Zyrtar për Regjistrimin të Bizneseve dhe "Zyrtar për Gjendje Civile 4" si kërkesa të përgjithshme formale janë paraparë: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin ne fuqi apo kur vlerësohet se janë te nevojshme për pozitat e kësaj klase; Përvoja e punës e kërkuar, nuk është kërkuar përvojë pune.* Ndërsa në pikën 8 të konkursit tek Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve është paraparë: *Testimi me shkrim, Vlerësimi i biografisë dhe intervistë.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit ka pasur shkelje procedurale dhe ligjore gjegjësisht ai pretendon se nuk janë publikuar rezultatet e testit me shkrim, mos mundësia e

ri-shikimit të testit me shkrim si dhe mos mundësia e parashtrimit të ankesës në fazën e vlerësimit të testit me shkrim po ashtu ai pretendon se Komisioni i Pranimit nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejtë pergjigjeve të cilat i ka dhënë në intervistën me gojë dhe se pyetjet nuk kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ky pretendim i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse në bazë të nenit 21 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është përcaktuar se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit të kandidatëve. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme të kërkuara për Grupin përkatës. 3. Testi me shkrim zhvillohet dhe vlerësohet në mënyrë elektronike. 4. Vlerësimi maksimal i mundëshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 5. Komisioni i Pranimit mund të zgjedh një grup pyetjesh, nga baza e të dhënave për testimin me shkrim, për testimin e fushës së njohurive, të aftësive e të cilësive të kërkuara për Grupin përkatës. Pyetjet hartohen sipas modelit, Zgjedhje e shumëfishtë, me një përgjigje të saktë. 6. Numri i pyetjeve të testimit me shkrim mund të jetë jo më pak se pesëdhjetë (50) pyetje dhe jo më shumë se shtatëdhjetë (70) pyetje. 7. Komisioni mban përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e informatave dhe testit me shkrim”, si dhe nenit 25 të Rregullores së lartcekur ku përcaktohet se: 25. Përfundimi i konkurrimit dhe shpallja e rezultatit 1. Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj. 2. Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje. 3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar se paku me shtatëdhjetë 70 pikë, Komisioni i Pranimit, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit pa fitues. Njësia Përgjegjëse publikon njoftimin për përfundimin e procedurës të konkurrimit pa fitues, në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje. 4. Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit. 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje’, ‘në rastin konkret në bazë të dokumentacioneve të ofruara Kolegji i Keshillit konstaton se rezultatet e testit me shkrim në mënyrë automatike i shkojnë çdo kandidati përmes sistemit elektronik (SIMBNJ) andaj edhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara ndërsa lidhur me pretendimin se Komisioni i Pranimit nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejtë pergjigjeve të cilat i ka dhënë në intervistën me gojë si dhe se pyetjet nuk kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet, Kolegji konstaton se pretendimet e ankuesit janë të pa qëndrueshme sepse ankuesi nuk ka arritur që të argumentoj me asnjë provë dhe dëshmi se Komisioni i ka bërë vlerësim të padrejte, respektivisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës se në bazë të dëshmive të ofruara konkretisht Vendimit me numër Nr. 02-020/04-0055996/23 të datës 03.08.2023 të Kryetarit të Komunitetit të Komunës së Podujevës ka konstatuar se Komisioni për Pranim në Komunën e Podujevës është themeluar në pajtim me nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në

Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili konform këtyre dispozitave ligjore është përgjegjës për zhvillimin e procesit të rekrutimit dhe se i njëjti është i pavarur sa i përket vlerësimit të kandidateve, prandaj ne baze të deshmive të ofruara nga palet konkretisht sipas dhe përgjigjes në ankesë të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës, konkretisht të datës 29.09.2023 është vërtetuar se kandidati në të gjitha fazat e rekrutimit, është vlerësuar drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore nga verifikimi paraprak deri tek faza e vlerësimit gjegjësisht nga vlerësimi i përgjithshëm, vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimit nëpërmjet intervistës me gojë dhe deri tek llogaritja e rezultatit përfundimtar, andaj Kolegji konstaton se vlerësimi i kandidatit është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se Komisioni i Pranimi ka shkelur paragrafin 3 të nenit 47 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranim dhe karrierë në Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht pyetjet e intervistës me gojë nuk kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet, Kolegji konstaton se ky pretendim është i pa bazuar sepse ankuesi gabimisht i'u është referuar dispozitave që kanë të bëjnë me procedurën e konkursit me numër të referencës RN00011927 të datës 21.06.2023, gjegjësisht dispozitat që i është referuar ankuesi rregullojnë procedurën për Lëvizjen Brenda Kategorisë.

Duke pasur parasysh që ankuesi ka arritur 67.42 pikë, në fazën e vlerësimit të testit me shkrim dhe jetëshkrimit dhe intervistës me gojë Kolegji vlerëson se Njoftimi me numër Nr.13-363/2023 i datës 19.09.2023 lidhur me kandidatin e përzgjedhur si dhe vendimi i kundërshtuar me ankese respektivisht Vendimi numër Nr.13-362/23 i datës 19.09.2023 i Komisionit të Pranimi lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit është nxjerr në pajtim me nenin 25 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Në kuptim të dispozitave e ligjore të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar ligjshmërinë e veprimeve procedurale që përbejnë tërësinë e procesit të pranimi sipas konkursit me Nr. Reference: RN00011927 për grupin *Specialit i Administrimit të Përgjithshëm* dhe si rrjedhojë nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale dhe materiale të cilat në esencë do ta bënin si të paligjshme këtë procedurë të pranimi, andaj mbi bazën e këtij konstatimi Kolegji konstaton se pranimi në këtë procedurë është bërë në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativoteknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve"*, nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë"*.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1186/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.